



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-12
**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt,
Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit**

Vendosi: Gjykatësja e Procedurës Paraprake
Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: E martë, 16 shtator 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kalendarin e Mbetur të Procedurës Paraprake

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Sofi Menegon
Luka Mishetiq

Mbrojtjes së Bashkim Smakajt
Xhonatan Ris
Hju Bauden

Mbrojtjes së Isni Kilajt
Ian Eduards
Xho Holms

Mbrojtjes së Fadil Fazliut
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Hajredin Kuçit
Aleksandër Admiral

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,¹në bazë të nenit 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 82(5), 95(2), (3), (4)(a) dhe (5), 98(1)(e)(ii) dhe 109(c) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 29 nëntor 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konfirmoi pjesërisht aktakuzën kundër Hashim Thaçit ("z. Thaçi"), Bashkim Smakajt ("z. Smakaj"), Isni Kilajt ("z. Kilaj"), Fadil Fazliut ("z. Fazliu") dhe Hajredin Kuçit ("z. Kuçi") (bashkërisht "të akuzuarit" dhe/ose "Mbrojtja") për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe rendit publik - konkretisht, tentim për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe/ose mosbindje ndaj gjykatës ("Vendimi i Konfirmimit").²

2. Më 16 prill 2025, në vijim të vendimit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake për ndryshimin³ e Vendimit të Konfirmimit ku u shtua një formë e përgjegjësisë

¹KSC-BC-2023-12, F00015, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake*, 6 qershor 2024, publik.

² KSC-BC-2023-12, F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 29 nëntor 2024, konfidencial, para. 313. Versioni i redaktuar u dorëzua më 12 shkurt 2025, [F00036/RED](#).

³Më 12 shkurt 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar apeloj Vendimin e Konfirmimit, me lejen e Gjykatësës së Procedurës Paraprake, dhe më 3 prill 2025, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi vendimin lidhur me apelimin e Prokurores së Specializuar dhe i ktheu një pikë për shqyrtim të mëtejshëm Gjykatësës së Procedurës Paraprake, *shih* KSC-BC-2023-12, F00149, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on Specialist Prosecutor's Request for Leave to Appeal the "Decision on the Confirmation of the Indictment"](#) (Vendim mbi Kërkesën e Prokurores së Specializuar për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës), 30 janar 2025, publik; IA002/F00012, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kundër Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 3 prill 2025, konfidencial. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u lëshua më 14 shkurt 2025, [IA002/F00012/RED](#).

penale,⁴ Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar (“Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar”).⁵

3. Më 25 korrik 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi ZPS-në të dorëzonte dosjen paraprake, listën e dëshmitarëve dhe të provave materiale të saj deri të premten, 19 shtator 2025, dhe informoi Mbrojtjen se synonte të caktonte afatet për dosjet paraprake përkatëse të tyre dhe informacion tjetër sipas rregullës 95(5) të Rregullores, të hënën, 20 tetor 2025.⁶

4. Më 25 gusht 2025, në vijim të urdhrit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake, ZPS-ja dorëzoi parashtrimet e saj duke dhënë informacion të mëtejshëm në lidhje me statusin e nxjerrjes së materialit dhe ekzaminimin e materialit të sekuestruar të të akuzuarit.⁷

5. Më 28⁸ dhe 29 gusht 2025,⁹ në vijim të urdhrit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake, Mbrojtja e z. Smakaj, z. Kilaj, Fazliu dhe z. Kuçi njoftuan Gjykatësen e

⁴ KSC-BC-2023-12, F00260, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision Amending the “Decision on the Confirmation of the Indictment” and Setting a Date for the Submission of Preliminary Motions](#) (Vendim për Ndryshimin e Vendimit mbi Konfirmim e Aktakuzës dhe Caktimin e Datës për Dorëzimin e Mocioneve Paraprake), 14 prill 2025, publik.

⁵ KSC-BC-2023-12, F00264, Prokurorja e Specializuar, [Submission of Amended Confirmed Indictment](#) (Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar), 16 prill 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale (që përfshin versionin konfidencial të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar), dhe [Annex 2](#) (Shtojcën 2), publike (që përfshin versionin e redaktuar publik të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar).

⁶ KSC-BC-2023-12, F00395, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Order Relating to the Calendar for the Remaining Pre-Trial Proceedings](#), Urdhër në lidhje me Kalendarin e Mbetur të Procedurës Paraprake, (“Urdhri”) 25 korrik 2025, publik, para. 16-17. Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu urdhëroi palët të dorëzojnë informacion të caktuar që ato i konsideronin të domosdoshme për të siguruar një organizim efikas dhe racional të pjesës së mbetur të procedurës paraprake dhe kalim të shpejtë të dosjes së çështjes Trupit Gjykues.

⁷KSC-BC-2023-12, F00420, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë sipas Urdhrit F00395 (“Parashtrimet e ZPS-së”)*, 25 gusht 2025, konfidenciale. Versioni i redaktuar u dorëzua më 5 shtator 2025, F00420/RED.

⁸KSC-BC-2023-12, F00424, Mbrojtja e Kilajt, *Parashtrime të Mbrojtjes së Kilajt sipas Urdhrit F00395 (“Parashtrimet e Kilajt”)*, 28 gusht 2025, publike. F00426, F00420, Mbrojtja e Smakajt, *Parashtrime të Mbrojtjes së Smakajt sipas Urdhrit F00395 (“Parashtrimet e Smakajt”)*, 28 gusht 2025, konfidenciale.

⁹KSC-BC-2023-12, F00425, Mbrojtja e Fazliut, *Parashtrime të Mbrojtjes së Fazliut sipas Urdhrit F00395 (“Parashtrimet e Fazliut”)*, 29 gusht 2025, publike. F00427, Mbrojtja e Thaçit, *Parashtrime të Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Kalendarin e Procedurës Paraprake (“Parashtrimet e Thaçit”)*, 29 gusht 2025, konfidenciale.

Procedurës Paraprake lidhur me synimin e tyre për dorëzimin e dosjeve paraprake dhe nuk kundërshtuan datën e propozuar.¹⁰ Mbrojtja e Thaçit parashtron se: (i) ajo pret të dorëzojë një dosje paraprake të kufizuar;¹¹ (ii) ajo parashikon se i nevojitet një periudhë prej rreth gjashtë (6) javëve pas marrjes së dosjes paraprake të ZPS-së;¹² (iii) kjo periudhë është thjesht një vlerësim dhe (iv) ajo do të jetë në gjendje të bëjë një kërkesë lidhur me kohën që i nevojitet brenda disa ditësh pas marrjes së dosjes paraprake të ZPS-së.¹³ Sipas parashtrimeve përkatëse të tyre, në këtë fazë, asnjë nga të akuzuarit nuk synon të përdorë alibinë.¹⁴ Mbrojtja e z. Fazliu dhe z. Kuçi tregojnë se ata synojnë të përdorin arsye të tjera që përjashtojnë përgjegjësinë penale.¹⁵ Mbrojtja e z. Thaçi, z. Kilaj dhe z. Smakaj tregojnë se ata nuk synojnë të mbështeten në arsye të tjera të përjashtimit të përgjegjësisë penale.¹⁶ Mbrojtja e Thaçit gjithashtu parashtron se, duke marrë parasysh kalendarin e parashikuar për pjesën e mbetur të çështjes *Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit* (KSC-BC-2020-06) ("Çështja 06"), çështja nuk mund t'i kalohet Trupit Gjykses deri në vendimin e apelit për dy mocione paraprake dhe pret të jetë gati për gjykim më 2 mars 2026.¹⁷

Një version i korigjuar u dorëzua më 3 shtator 2025, F00427/COR dhe një version i redaktuar publik i parashtrimit të korigjuar u dorëzua të njëjtën datë, F00427/COR/RED; F00429, F00420, Mbrojtja e Kuçit, *Parashtrime të Mbrojtjes së Kuçit sipas Urdhrit F00395 ("Parashtrimet e Kuçit")*, 29 gusht 2025, publike.

¹⁰ Parashtrimet e Mbrojtjes së Smakajt, para. 6, Parashtrimet e Mbrojtjes së Kilajt, para. 8, Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 7, Parashtrimet e Mbrojtjes së Kuçit, para. 6.

¹¹ Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 16.

¹² Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 17.

¹³ Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 18.

¹⁴ Parashtrimet e Mbrojtjes së Kilajt, para. 7. Parashtrimet e Mbrojtjes së Smakajt, para. 5. Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 5-6 (Gjykatësja e Procedurës Paraprake kupton nga paragrafët 5-6 të Parashtrimeve të Mbrojtjes së Fazliut se Mbrojtja e Fazliut nuk synon të paraqesë alibi); Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 15. Parashtrimet e Mbrojtjes së Kuçit, para. 5.

¹⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 5. Parashtrimet e Mbrojtjes së Kuçit, para. 5.

¹⁶ Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 15. Parashtrimet e Mbrojtjes së Kilajt, para. 7. Parashtrimet e Mbrojtjes së Smakajt, para. 5. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Kilajt rezervojnë të drejtën për ndryshimin e qëndrimit të tyre pasi ZPS-ja të përmbushë plotësisht detyrimet për nxjerrjen e materialit dhe të dorëzojë dosjen e saj paraprake.

¹⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 19-20.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Sipas nenit 39(13) të Ligjit, kur është e nevojshme, me kërkesë të saj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të lëshojë çfarëdo urdhri që mund të jetë i nevojshëm për përgatitjen e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë. Në pajtim me rregullën 95(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake sigurohet që procedura paraprake të mos ketë vonesa të papërligjura dhe merr masat e nevojshme për përgatitjen e shpejtë të çështjes për gjykim.
7. Në pajtim me rregullën 95(2)(j) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos një datë brenda së cilës çështja duhet të jetë gati për gjykim.
8. Në pajtim me rregullën 95(3) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake evidenton pikat juridike dhe faktike për të cilat palët pajtohen.
9. Në pajtim me rregullën 95(4)(a) të Rregullores, dosje paraprake e Prokurorit të Specializuar përfshin çfarëdo pranimi në lidhje me faktet nga ana e Mbrojtjes, si edhe një listë të pikave që nuk kontestohen.
10. Në pajtim me rregullën 95(5) të Rregullores, pas dorëzimit të materialeve të përmendura në rregullën 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake fton Mbrojtjen që brenda një afati të përcaktuar të dorëzojë dosjen e vet paraprake, duke treguar (a) në vija të përgjithshme, natyrën e mbrojtjes së të akuzuarve; (b) akuzat dhe aspektet për të cilat të akuzuarit nuk pajtohen, përmes referimit në paragrafë të caktuar në dosjen paraprake të Prokurorit të Specializuar dhe arsyet pse të akuzuarit i kontestojnë ato; (c) një listë të dëshmitarëve të mundshëm që Mbrojtja synon të thërrasë; në lidhje me secilin dëshmitar, Mbrojtja specifikon se me cilën pikë konkrete lidhet dëshmia përkatëse. Gjithashtu, brenda një afati të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Mbrojtja informon ZPS-në mbi synimin e vet për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale.
11. Në pajtim me rregullën 98(1) të Rregullores, pas marrjes së parashtrimeve nga Prokurori i Specializuar dhe Mbrojtja sipas rregullës 95(4-5) dhe rregullës 97 të

Rregullores, dhe brenda tridhjetë (30) ditësh pas daljes së çdo vendimi të formës së prerë në lidhje me mocionet paraprake, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kalon Trupit Gjykues dosjen e plotë të çështjes gjyqësore, e cila përmban, ndër të tjera, pikat për të cilat palët pajtohen.

12. Në pajtim me rregullën 109(c) të Rregullores, pala e kategorizon informacionin në përputhje me akuzat e aktakuzës, duke iu referuar veprave penale konkrete që përbëjnë bazën e tyre, elementet kontekstuale të veprave penale, veprimet e pretenduara të të akuzuarit, ose, kur është e zbatueshme, provat që do të paraqiten nga Prokurori i Specializuar.

13. Sipas rregullës 82(5) të Rregullores, në qoftë se arsyet për një klasifikim të caktuar pushojnë së ekzistuari, dorëzuesi i parashtrimit të parë i paraqet Panelit kërkesë për riklasifikim. Gjithashtu, Paneli mund të ndryshojë statusin e një parashtrimi të protokolluar, me kërkesë të një pjesëmarrësi tjetër në proces, apo *proprio motu*.

III. DISKUTIM

A. AFATI PËR DOSJET PARAPRAKE TË MBROJTJES DHE INFORMACION TJETËR

14. Gjykatësja e Procedurës Paraprake mban parasysh faktin se, për telefonat e sekuestruar të të akuzuarve, ZPS-ja ka nxjerrë, kur është e zbatueshme, materialet mbi të cilat ajo synon të mbështetet në gjykim sipas rregullave 102(1)(a) dhe 102(1)(b) të Rregullores.¹⁸ Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu vëren se një pjesë e vogël e ekzaminimit të materialit të sekuestruar prej të akuzuarve ende nuk ka përfunduar, pjesa më e madhe e së cilës varet nga përfundimi i punës nga Kompania e Jashtme Forenzike dhe rishikimi nga Mbrojtësja e Pavarur, por se ZPS-ja (i) nuk parashikon që rishikimi i mbetur të ndikojë në kryerjen e shpejtë të procesit; dhe (ii) ajo do të vijojë

¹⁸Parashtrimet e ZPS-së, para 5.

me rishikimin dhe nxjerrjen me zell të materialeve sapo t'i marrë ato.¹⁹ Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu vëren se disa materiale në numrin e kufizuar të materialeve për të cilat ZPS-ja mund të kërkojë leje për t'i nxjerrë sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores, i janë njoftuar tashmë Mbrojtjes përmes përfshirjes së tyre në Njoftimin e Katërt të ZPS-së sipas Rregullës 102(3).²⁰ Duke marrë parasysh, gjithashtu, grupin e kufizuar të kërkimeve shtesë të nevojshme lidhur me materialet e sekuestruara prej z. Thaçi, dhe ekzekutimin dhe rishikimin e menjëhershëm nga Mbrojtësja e Pavarur të materialit të mbetur të sekuestruar prej z. Kuçi – të dyja grupe materialesh për të cilat të dy të akuzuarit kanë njohuri të hollësishme – Gjykatësja e Procedurës Paraprake është e mendimit se nxjerrja e provave në këtë çështje është në rrugën e duhur dhe nuk parashikon ndonjë vonesë domethënëse në proces që do të ndikonte në afatin e dorëzimit të dosjeve paraprake të Mbrojtjes.

15. Gjithashtu, ZPS-ja do të dorëzojë më 19 shtator 2025 dosjen e saj paraprake, e cila përmban për çdo akuzë një përmbledhje të provave të cilat ZPS-ja synon t'i paraqesë në lidhje me kryerjen e veprave penale të pretenduara dhe format e përgjegjësisë penale të pretenduar të të akuzuarve.²¹ Së bashku me dosjen paraprake, Mbrojtja gjithashtu do të marrë listën e dëshmitarëve dhe të provave materiale.²² Në atë moment, këto prova do të jenë nxjerrë për Mbrojtjen në pajtim me vendimet e Gjykatësës së Procedurës Paraprake, ose kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara.²³ Gjithashtu, rikujtohet se të akuzuarit janë informuar lidhur me akuzat dhe materialet ku mbështetet Vendimi i Konfirmimit dhe Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar kundër z. Thaçi.²⁴ Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu rikujton

¹⁹Parashtrimet e ZPS-së, para. 2.

²⁰Parashtrimet e ZPS-së, para 24.

²¹Rregulla 95(4)(a) e Rregullores.

²²Rregulla 95(4)(b) dhe (c) e Rregullores.

²³Kjo nuk cenon asnjë kërkesë për ndryshimin e listave të dëshmitarëve dhe të provave materiale, në pajtim me rregullën 118(2) të Rregullores.

²⁴ KSC-BC-2023-12, F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 29 nëntor 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 12 shkurt 2025, [F00036/RED](#). F00017/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar më Tej*, 12 nëntor

se kjo çështje është me kompleksitet të kufizuar faktik dhe juridik, dhe ka të bëjë me pretendime për vepra penale sipas nenit 15(2) të Ligjit, me fushëveprim të kufizuar kohor dhe gjeografik.²⁵ Vlen të theksohet se, në kundërshtim me çfarë pretendon Mbrojtja e z. Thaçi,²⁶ fushëveprimi i akuzave, në mënyrën që ato përshkruhen në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar, është i qartë dhe nuk do të ndryshojë deri në gjykim.²⁷ Në këtë aspekt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren pretendimin e Mbrojtjes së Thaçit se “aspekte thelbësore të argumenteve të ZPS-së ende nuk i janë bërë të ditura Mbrojtjes dhe priten të bëhen të ditura vetëm pas marrjes së dosjes paraprake, listave të provave materiale dhe listës së dëshmitarëve të ZPS-së”.²⁸ Megjithatë, Mbrojtja e Thaçit nuk shtjellon se cilat aspekte “thelbësore” mbeten të paqarta, apo nuk justifikon pse i nevojitet dosja përfundimtare dhe listat e dëshmitarëve dhe të provave materiale të ZPS-së që të jetë në gjendje të bëjë një kërkesë konkrete lidhur me kohën që i nevojitet për të dorëzuar dosjen paraprake.²⁹ Për këto arsye, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se argumentet e z. Thaçi nuk janë bindëse dhe konsideron se Mbrojtja i zotëron elementët themelorë të argumenteve të ZPS-së në kohën kur ftohet të dorëzojë dosjen paraprake të saj.

16. Së fundi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja e z. Smakaj, z. Kilaj, z. Fazliu dhe z. Kuçi treguan se ishin të përgatitur të dorëzonin dosjet paraprake

2024, konfidenciale (që përfshin përshkrimin sipas rregullës 86(3)). Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, më 16 prill 2025, ajo konfirmoi në lidhje me z. Thaçi një formë shtesë të përgjegjësisë penale, në vijim të një vendimi të Panelit të Gjykatës së Apelit, i cili nuk kërkonte asnjë material shtesë sipas rregullës 86(3) të Rregullores.

²⁵ KSC-BC-2023-12, F00100, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To*, 20 dhjetor 2024, publik, para. 82.

²⁶Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 6.

²⁷Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se mocioni paraprak që pretendonte mangësi në Aktakuzë u hodh poshtë, shih KSC-BC-2023-12, F00347, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet Paraprake për Mangësi në Aktakuzë*, 24 qershor 2025, publik. Një kërkesë lidhur me të që kërkonte leje për apelim të këtij vendimi gjithashtu u rrëzua, shih F00392, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesat e Thaçit dhe Fazliut për Leje për Apelim të “Vendimit mbi Mocionet Paraprake për Mangësi në Aktakuzë”*, 24 korrik 2025, publik.

²⁸Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 17.

²⁹Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 18.

përkatëse në datën e propozuar.³⁰ Në këtë kontekst, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se në dosjet paraprake të tyre, Mbrojtjes i kërkohet të përshkruajë në vija të përgjithshme natyrën e mbrojtjes për të akuzuarit, siç parashihet sipas rregullës 95(5) të Rregullores. Në rrethanat konkrete, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konsideron se Mbrojtja është në gjendje ta bëjë këtë, nëse dëshiron.

17. Përveç aspekteve të lartpërmendura dhe për të siguruar një organizim efikas të pjesë së mbetur të procedurës paraprake dhe kalim të shpejtë të dosjes së çështjes Trupit Gjykues, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se është e përshtatshme të ftojë ekipet e Mbrojtjes të dorëzojnë dosjet paraprake të tyre deri të **hënën, 20 tetor 2025**, ku të tregojnë (i) në vija të përgjithshme, natyrën e mbrojtjes së të akuzuarve; (b) akuzat dhe aspektet për të cilat të akuzuarit nuk pajtohen, përmes referimit në paragrafë të caktuar në dosjen paraprake të ZPS-së dhe arsyet pse të akuzuarit i kontestojnë ato; dhe (iii) listën e dëshmitarëve të mundshëm që Mbrojtja synon të thërrasë, e cila nuk paragjykon ndryshime të mëvonshme të saj. Në lidhje me secilin dëshmitar, Mbrojtja duhet të specifikojë se me cilin aspekt konkret lidhet dëshmia përkatëse.

18. Njëkohësisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake fton Mbrojtjen të njoftojë ZPS-në lidhur me synimin e tyre për të përdorur çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale, siç parashihet sipas rregullës 95(5) të Rregullores, deri të **hënën, 20 tetor 2025**.³¹

B. PIKAT E PAJTIMIT PËR ASPEKTE JURIDIKE DHE FAKTIKE

19. Gjykatësja e Procedurës Paraprake merr parasysh parashtrimet e ZPS-së se ajo i komunikoi Mbrojtjes një listë të pikave të propozuara mbi aspekte juridike dhe

³⁰Shih para. 4 më lart.

³¹ Gjykatësja e Procedurës Paraprake mban parasysh faktin se, në këtë fazë, asnjë nga të akuzuarit nuk synon të përdorë alibinë, dhe se Mbrojtja e z. Fazliu dhe z. Kuçi tregojnë se ata synojnë të përdorin arsye të tjera që përjashtojnë përgjegjësinë penale. Për këtë arsye, Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të përcaktojë vetëm afatin në lidhje me detyrimin e Mbrojtjes për të njoftuar Prokurorin e Specializuar për çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale.

faktike për të cilat palët pajtohen, dhe se Mbrojtja synon të dorëzojë një përgjigje të përbashkët pas dorëzimit të dosjes paraprake të ZPS-së.³² Për të siguruar avancimin e kalimit të çështjes, Gjykatësja e Procedurës Paraprake fton palët të mbajnë kontakte, nëse nuk e kanë bërë këtë më parë, dhe fton ZPS-në t'i dorëzojë asaj çdo pikë pajtimi për aspektet juridike dhe faktike, jo më vonë se **të hënë, 30 shtator 2025**, me një parashtrim të protokolluar në dokumentacionin e çështjes.

C. TABELA SIPAS RREGULLËS 109(C).

20. Gjykatësja e Procedurës Paraprake u kujton palëve detyrimin e tyre për dorëzimin e tabelave sipas rregullës 109(c) brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të dosjeve paraprake përkatëse të tyre.³³

D. DATA PARAPRAKE PËR KALIMIN E ÇËSHTJES TRUPIT GJYKUES

21. Sa i takon datës paraprake për kalimin e çështjes Trupit Gjykses, Gjykatësja e Procedurës Paraprake është e mendimit se kalendari i parashikuar për pjesën e mbetur të procesit gjyqësor në Çështjen 06, siç konceptohet nga Mbrojtja e Thaçit,³⁴ nuk mund të përcaktojë ritmin e kësaj çështje, e cila përfshin gjithashtu katër të akuzuar të tjerë, pa lidhje me Çështjen 06, të cilët kanë të drejtën e gjykimit të drejtë. Pasi peshoi të gjitha argumentet, Gjykatësja e Procedurës Paraprake informon palët se ajo synon t'ia kalojë çështjen trupit gjykses në gjysmën e parë të nëntorit 2025, në qoftë se kjo lejohet nga vendimet e ardhshme të Panelit të Gjykatës së Apelit mbi apelet e paraqitura në lidhje me mocionet paraprake.

IV.

22. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se parashtrimet e Mbrojtjes së Smakajt (F00426) janë dorëzuar si konfidenciale. Për të respektuar parimin e gjykimit publik,

³²Parashtrimet e ZPS-së, para. 21-22.

³³Vendimi Kornizë, para. 82. *Shih gjithashtu F00153, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, Vendim mbi Miratimin e Tabelës sipas Rregullës 109(c), 5 shkurt 2025.*

³⁴Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 20.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëron Mbrojtjen e Smakajt të kërkojë riklasifikimin e parashtrimeve si publike, ose të dorëzojë versionin e redaktuar publik të tyre jo më vonë se **të martën, 16 shtator 2025**.

V. VENDIM

23. Për arsyet sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake:

- (a) **FTON** Mbrojtjen të dorëzojë dosjet paraprake të tyre, siç parashihet sipas rregullës 95(5) të Rregullores, deri **të hënën, 20 tetor 2025**;
- (b) **FTON** Mbrojtjen të njoftojë ZPS-në lidhur me synimin e tyre për të përdorur çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale, siç parashihet sipas rregullës 95(5) të Rregullores, deri **të hënën, 20 tetor 2025**.
- (c) **URDHËRON** ZPS-në t'i dorëzojë asaj çdo pikë pajtimi për aspektet juridike dhe faktike, siç parashihet sipas rregullës 95(3) të Rregullores, deri **të hënën, 30 shtator 2025**, me një parashtrim të protokolluar në dokumentacionin e çështjes;
- (d) **KUJTON** palët për detyrimin e tyre për dorëzimin e tabelave sipas rregullës 109(c) brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të dosjeve paraprake përkatëse.
- (e) **INFORMON** palët se ajo synon t'i kalojë çështjen Trupit Gjykues në gjysmën e parë të nëntorit 2025; dhe
- (f) **URDHËRON** Mbrojtjen e Smakajt të dorëzojë versionet e redaktuara publike të parashtrimit përkatëse të saj (F00426), ose të kërkojë riklasifikimin e tij si publik, jo më vonë se **të premten, 19 shtator 2025**.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Marzhorit Masëlo
Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E martë, 16 shtator 2025

Në Hagë, Holandë